

## RECEPTIMI I VEPRËS SË MALOKIT KRIST MALOKI WORKS'S RECEPTION

EDLIRA GUGU  
Tiranë, SHQIPËRI  
Email: edagugu@yahoo.com

**AKTET VI, 4: 400-406, 2013**

### PËRMBLEDHJE

Ky punim ka si objekt të tij receptimin e veprës së kritikut Krist Maloki. Në hulumtimet e bëra u konstatua që receptimi i veprës së Malokit mund të klasifikohet në bazë të dy tipologjive. Ky klasifikim mbështetet në dy periudha kohore para viteve 1944 dhe pas viteve 1999. Shqyrtimi është organizuar mbi receptimin që i është bërë shkrimeve të Malokit në nivel historik. Punimi evidenton që receptimi i shkrimit kritik të Malokit shfaqet heterogjen. Dallohen tri tipe vlerësimesh: moskuptim, vlerësim maksimal, përpjekje për një vlerësim objektiv. Për klasifikimin në tipe vlerësimesh janë marrë në konsideratë si shkrimet me karakter letrar, ashtu edhe ato me karakter social.

Në periudhën e dytë të tipologjisë shkrimet e Malokit janë klasifikuar në bazë të këtyre çështjeve:

- kritika e Malokit në kontekstin e kritikës shqipe të kohës,
- shkrimet kritike letrare,
- shkrimet me karakter social,
- vendosja e ideve të tij në kontekstin sotëm,
- vlerësimi i kritikës së Malokit.

**Fjalet kyçe** : Krist Maloki, receptimi, vepra, tipologji, shkrime kritike

### SUMMARY

The purpose of this paper is the reception of works of the critic Krist Maloki. In field researchs, Maloki's works reception, is classified in two typology based on historic periods before 1944 and after 1999. Establishing these time limits, the study is organised on the reception of Maloki's works in historic level. The paper identifies that the reception of critical works of Maloki was heterogeneous. The reception is classified in three types of assessment: misunderstanding, maximal assessment, objective assessment effort. These types of assessments took into consideration the critical literary writings also the social critical writings.

In the second period of typology Maloki's writing's are classified based on these issues:

- Maloki's criticism in the context of the Albanian literary criticism,
- literary critical writings,
- social critical writings,
- setting his ideas and concepts in context and now days reality,
- the assessment of Maloki's criticism.

**Key words**: Krist Maloki, reception, works, typology, critical writings

---

**Tipologji të receptimit në dy periudha kohore**  
Maloki filloi hershëm të ishte aktiv në rrethet kulturore shqiptare. Ndër shkrimet e para të tij

ishte ai për Naim Frashërin e më tej do të ketë tekste pasues, të cilët do t'i përkisnin fushave të ndryshme. Kryesisht këto tekste janë botuar në

periodikun kohës brenda vendit, por pati edhe nga ato që Maloki do t'i botonte jashtë vendit.

Këto shkrime tërhoqën vëmendjen për një qëndrim të rreptë kritik e këndvështrim origjinal, i cili karakterizohej nga një kulturë e thellë.

Natyrshëm do të lindin dy pyetje :

- *A ishte i nevojshëm një receptim i shkrimeve kritike të Malokit?*

- *Si u receptua vepra e Malokit?*

Shqyrtimi i receptimit kritik të veprës së një autori i cili sjell një model të ri të veçantë duke tentuar të provokojë sistemin kritik letrar, përbën një çështje me rëndësi, sepse nuk mund të konceptohet vendi që zë në kritikën shqipe, nga ana historike, pa pjesëmarrjen aktive të receptuesve që u drejtohet. Ashtu si vepra letrare edhe shkrimi kritik vendos një raport dialogues me lexuesin. Për këtë arsye ky dialog do të nxjerrë në dukje vlerën e vërtetë të shkrimit kritik dhe njëkohësisht marrëdhënien që ekziston mes nxitjes dhe përgjigjes (Jauss 2001: 34). E parë në këtë kuadër vlen të shihet lidhja e shkrimit kritik të tij me hapësirën e historisë së kritikës letrare shqipe.

Nga sa më sipër duket e domosdoshme një pasqyrë tipologjike e receptimit kritik mbi shkrimin kritik të Malokit. Kufijtë kohorë do të jenë të dy përmasave. Para viteve 1944 dhe pas viteve 1999 kur shkrimet e Malokit rifilluan të shohin dritën e qarkullimit. Gjatë viteve 1945-1990 Maloki dhe vepra e tij si shumë të tjerë u mohuan për pasojë receptuesi e shkëputi tërësisht marrëdhënien me shkrimet kritike të tij. Duke vendosur këta kufij kohorë, shqyrtimi organizohet mbi receptimin që i është bërë shkrimeve të Malokit në nivel historik, pasi mënyra se si një vepër letrare e në rastin tonë shkrimi kritik në momentin historik të shfaqjes, mban, tejkalon, zhgënjën, ose mohan pritjen e publikut të saj të parë, na shtyn ta shohim si kriter për të përcaktuar vlerën e tyre. Receptimi i shkrimit kritik të Malokit shfaqet heterogjen. Ai mund të klasifikohet në tri tipe vlerësimesh: Moskuptim, vlerësim maksimal, përpjekje për vlerësim objektiv.

## 1. Tipologjia receptimit në periudhën I

Bazuar në *studimin e efekteve që tekstat ushtrojnë te lexuesi – operacion ky që vë në dyshim të gjithë kriteret tradicionalë të analizës historike* – sipas Jauss, shkrimet e Malokit kanë ngjallur polemika. Por e gjej të arsyeshme të shtoj se pavarësisht kësaj, pasqyrimi në shtypin e kohës është i pakët. Edhe pse janë pak në numër, do t'i referohem dy shkrimeve të cilat i drejtohen dy aspekteve të rëndësishme të kritikës së Malokit: kritikës letrare dhe shkrimeve me karakter socio-logjik.

- Poetë dhe detraktorë
- Gjurmime në shpirtin e shqiptarit (mbas studimeve të Dr Krist Malokit).

Tek teksti i parë i shkruar nga Mitrush Kuteli "*Poetë dhe detraktorë*" (Kuteli 2007: 285) u botua si kundërpërgjigje shkrimit të Malokit "*A asht poet Lasgush Poradeci?*". Kuteli e nis tekstin e tij duke dhënë në hyrje konceptet për artin, poezinë dhe vlerat e saj, krijimin letrar, si dhe poetin duke bërë të mundur shfaqjen e parimeve të tij për to. Sipas tij arti është prodhimi më fisnik i shpirtit të njeriut. Poezia është intuitë e ndjenjë, -jo logjikë. Ajo del nga shpirti e i drejtohet shpirtit (Kuteli 2007: 285). Është e qartë që të dy kritikët përdorin mënyra të ndryshme leximi. E bazuar në konceptin e Jaussit që shkrimi/vepra letrare është e kompletuar me elementë që përgatisin lexuesin për pritje të duhura, që në fillim ushqen pritje për atë që do të vijojë si dhe për përfundimet. Ajo i sugjeron lexuesit një qëndrim të caktuar emocional, dhe në një mënyrë mundëson një horizont të përgjithshëm për kuptimin e saj. Mund të thuhet që shkrimi kritik i Malokit, duke guxuar dhe duke dalë jashtë perceptimit të zakonshëm, patjetër që e përgatiti terrenin për t'u prituri në këtë mënyrë, duke mundur kështu të vendosë efektin e madh të shkrimit kritik.

Ndryshe do të shfaqet në shtypin e kohës shkrimi i botuar në revistën "*Leka*". Artikulli i referohet shkrimeve me karakter social të Malokit "*Shpirti i shqiptarit*". Në shkrimin "*Gjurmime në shpirtin e shqiptarit*" (mbas studimeve të Dr Krist Malokit) ("*Leka*" 1934, nr. 3: 79-85) autori i këtij teksti s'bën gjë tjetër veçse i merr në konsideratë opinionet dhe analizën që i bën Maloki cilësive të

shqiptarit për t'i referuar në lidhje me kontekstin e kohës dhe njëkohësisht i sheh si shtysë motivuese për të ecur përpara dhe për të sjellë ndryshimin në realitetin shqiptar.

Sipas Jauss-it *horizonti i pritjes* është përcaktuar objektivist nga sistemi sociokulturor, të cilit teksti i referohet. Në këtë mënyrë edhe shkrimet me karakter social të Malokit në kuadër të kontekstit të kohës i drejtohen këtij horizonti pritjeje.

## 2. Tipologjia e receptimit në periudhën II

Përfaqësuesit e tipit të dytë dhe të tretë do të jenë shkrimtarë e kritikë brenda dhe jashtë kufijve të cilët do të botojnë opinionet e tyre kryesisht në periodikun e kohës pas viteve 1999 në gazeta dhe revista si dhe në parathënie të veprës së përmbledhur të Malokit ("*Oriental apo occidental?*", Tiranë 2003; *Refleksione*, Prishtinë 2005). Përjashtim bën në këtë kontekst shkrimi i Hamdi Oruçit (Oruçi, 1973: 149-166), i cili është botuar rreth viteve 1973 në nderim të kujtimit të tij pas vdekjes. Këto shkrime do të kenë si qëllim rivlerësimin e figurës së Malokit dhe njëkohësisht njohjen e vlerave të vërteta të kritikës së shkruar prej tij. Duhet theksuar se receptimi i veprës së Malokit në këtë periudhë vjen si rezultat i *zhvillimit të horizontit letrar*, i cili tashmë ka *krijuar mundësi të reja leximi*. Kjo ka sjellë në rikuperimin e plotë të figurës dhe të veprës së Malokit për shkakun edhe të faktorëve të jashtëm.

Përgjithsisht receptimi është marrë me këto aspekte të shkrimeve të Malokit: *Kritika e Malokit në kontekstin e kritikës shqipe të kohës, shkrimet kritike letrare, shkrimet me karakter social, vendosja e ideve dhe koncepteve të tij në kontekstin dhe realitetin e sotëm të kohës, vlerësimi i kritikës së Malokit*.

### 2.1 Kritika e Malokit në kontekstin e kritikës shqipe të kohës

Kryesisht të gjitha shkrimet e botuar në periodikun e viteve të fundit, të cilat janë marrë me figurën e Krist Malokit kanë marrë në konsideratë pozicionin e tij brenda kontekstit të kritikës

letrare shqipe dhe mendimit estetik të kritikë të kohës.

Në përgjithësi në mendimin e studiuesve dhe të kritikëve të kohëve të fundit, Maloki do të shihet si një nga kritikët potencial, kontributi dhe roli i të cilit është i një përmase të gjerë. Për Ndrëçim Kullën në artikullin "*Mendimtar i cilësisë*" (Kulla 2001: 14) Maloki do të shihej si përfaqësues i mendimit politik-filozofik sociologjik e kulturor të viteve 1920-1940, i cili u dënua të konservohej nga çensura komuniste për shkak të faktit se ishte ndërtuar me parime të kundërta nga sistemi ekonomiko-shoqëror për të cilin ishte zhvilluar mendimi i tyre. Behar Gjoka (Gjoka 2003: 18) meritat që kanë intelektualët shqiptarë të kohës, ku përfshihet edhe Maloki i sheh në disa aspekte të rëndësishme, midis të tyre veçon përpjekjen sizifiane për të zbuluar dobësitë njerëzore, që i kemi herë-herë me të tepert ne shqiptarët.

## 3. Shkrimet kritike letrare

Përsa i përket shkrimeve të kritikës letrare Hamdi Oruçi (Oruçi 1973: 149 – 166) do t'i njohë meritën Krist Malokit si *i pari kritik shqiptar që përdori methodhën introspektive*, vlerësim ky që do të pohohej më vonë edhe nga studiues të tjerë si Ndrëçim Kulla (Kulla 2001: 19), Isak Ahmeti (Ahmeti 1999: 9).

Për Rugovën shkrimet kritike të Malokit janë vështrime. Ai shton se për të interpretuar këto tekste, do të niset nga këndvështrimi psikanalitik, psikobiografia tradicionale e kulturorhistorike duke shtuar *një metodologji me vlerë si përvojë të mendimit kritik shqiptar*.

Për kritikën drejtuar Naim Frashërit, Rugova thekson se Maloki niset nga raporti trikotomik duke shpallur se do të merret me personën e Naimit (shpirtin e tij). Rugova njeht faktin që Maloki do të bazohet në kritikën e tij methodën e psikologjisë analitike, duke njohur si cilësi të saj raportin specifik të Naimit me nënën duke e kristalizuar figurën e saj tek *tipi i nënës së Skëndërbeut apo si faj tragjik qëndrimin e poetit në gjimnazin grek "Zosimea"* (Rugova 2005: 138). Të njëjtin opinion konstaton edhe Koço Bihiku (Bihiku 2000: 105-110), i cili e shikon kritikën e Malokit drejtuar Naim Frashërit si: *tendencë për të karakterizuar*

*personin dhe krijimtarinë e poetit të shquar të Rilindjes kombëtare duke i kushtuar vëmendje biografisë, brengave dhe vuajtjeve, formimit të tij moral e shpirtëror.* Nisur nga kjo ai vuri në dukje se, hapat e parë si krijues Naim Frashëri i bëri nën ndikimin e poezisë persane, e cila ishte-përshkuar nga “fryma mistike-fetare” dhe deri diku në erotikë, duke përcaktuar karakterin e lirikave të para të poetit”.

Për Lasgushin Rugova pohon se nisur nga premisa të psikanalizës dhe kulturohistorikja duke evidentuar veçoritë specifike të tyre e duke shtuar se e meta e Malokit në vështrimet e tij kritike qëndronte (sidomos në shkrimin për Lasgushin), në faktin se *ai nuk vërente sa duhet shpërndërrimin e poezisë dhe gjuhës poetike* (Rugova 2005: ), duke identifikuar kështu problemin e dytë në kritikën e Malokit, e cila kishte të bënte me ndryshimin e perceptcionit dhe të ligjëritimit të poezisë që nuk ishte problem vetëm i tij (Rugova 2005: 108-113). Edhe nga Bihiku kritikën për Lasgushin do ta interpretojë në kuadër të polemikës së tij me Kutelin, ku ai do të evidentojë thelbin e mospajtimit të mendimit të Malokit me Kutelin. Përpos mendimeve të dy kritikëve, Bihiku njëkohësisht do të shtojë se pavarësisht se në poezinë e Lasgushit *nuk gjetën jehonë ngjarjet e mëdha historike të së kaluarës, në lirikat e tij si ato me temë shoqërore, ashtu edhe ato të peisazhit përshkohen nga dashuria e flaktë për vendin të shfaqura në mënyrë të veçantë.*

Ndriçim Kulla (Kulla 2001: 19) thekson faktin që shkrimet e tij mbi Naimin dhe Lasgushin nuk janë kuptuar, pasi ishte i pari që vuri dorë mbi monumentet e tyre duke tentuar t'i portretizojë më realisht pa i lëvizur nga piedestalet e tyre. Për Behar Gjokën (Gjoka 2003: 18): *shkrimi për Lasgushin mbart edhe dëshminë e polemikës, gjë që dominon tonalitetin e shprehësisë, pra si një reagim i menjëhershëm, veçse një reagim i argumentuar sipas parametrave të letraritetit.*

Nga ana tjetër parashtesa e Kutelit është mjaft me vlerë në shqyrtimin e poezisë së Lasgushit, është një dimension tjetër leximi. Për Gjokën dy përvojat e kritikës letrare janë dy anë të së njëjtës medalje, verifikim i vlerave të poetikës së

Lasgushit. Në trajtesën kushtuar N. Frashërit, Gjoka shton se autori rreket të zbulojë rrënjët dhe formatin e personalitetit të poetit duke e shoqëruar ngahera edhe me shqyrtime të teksteve naimjane.

Kojo Bihiku (Bihiku 2003: 3) do të sjellë në vëmendje të lexuesit një tjetër aspekt të kritikës letrare të Malokit. Sipas Bihikut, Maloki, u përmbahej parimeve metodologjike konservatore që shquanin shkencën akademike universitare, kurse në shkrimet politike shoqërore qëndronte në pozita të djathta ekstreme që i bëri një karakterizim të plotë Fishtës si poet dhe si personalitet publik.

Në shkrimet e Malokit për *Lahutën e Malcis* të Fishtës, Bihiku vëren se ai është nisur t'i trajtojë nga konceptete filozofike mitologjike “profet e pris”, “hero i popullit”, duke e parë figurën e Fishtës të lidhur ngushtë me shqetësimet e kombit, me lartësimin e shpirtit liridashës (Bihiku 2003: 3). Konstatim i rëndësishëm është edhe ky: shkrimet për Fishtën janë objektive dhe qëndrojnë më lart për nga cilësia jo vetëm për në përqasje me artikujt e studimet e Malokit para vitit 1960, por edhe me ato të botuara në dhjetëvjeçarin e fundit.

Në vëmendje të publicistikës shqipe të kohëve të fundit do të jetë edhe koncepti i Malokit për “Poetin” “Dichter”. Besiana Lushaj (Lushaj 2007: 13) në kërkim të një reagimi mbi tezën e Malokit rreth konceptit se çfarë atributesh duhet të ketë një poet të quhet kombëtar, një temë e rigjetur në shkrimet publicistike të disa autorëve bashkëkohorë kosovarë dhe shqiptarë të Maqedonisë, evidenton mendimin e Arjan Lekës mbi poetët kombëtarë në fillim të shek. XX se ka qenë i rëndësishëm pasi procesi i komb-formimit shqiptar ka kaluar nëpër duart e poetëve aq sa figura e tij është kthyer në një “shenjt” gati parathënës i fatit në botkuptimin shqiptar, lidhur me fatet e trazuara të kombit.

#### **4. Shkrimet me karakter social**

Shkrimet me karakter social të Malokit shpesh janë gjendur në qendër të vëmendjes së shtypit publicistik të kohëve të fundit. Ato përveçse ritheksojnë konceptet e tij për zhvillimin e kombit

e të shoqërisë shqiptare, shpesh japin edhe këndvështrime aktuale të studiuesve të sotëm. Koço Bihiku (Bihiku 2000: 105-110) merr në konsideratë tekstin “*Kombi në rrezik*”, ku theksin e vë në analizën që i bën autori fakteve për zhvillimin e ekonomisë dhe arsimit shqiptar duke ngritur kushtimin “*Kombi në rrezik*”. Ndërkaq në tekstin “*Oriental apo okcidental*” ai do të evidentojë pjesëmarrjen e Malokit në polemikë, duke pohuar se ai i kushton vëmendje kuptimit të termit “*orientalist*”.

I nisur nga një këndvështrim tjetër Enis Sulstarova, sqaron konceptin e orientalizmit dhe ndërton kontekstin e orientit të kohës në Europë e më pas në Shqipëri. Për Sulstarovën, Maloki proçedon në këtë mënyrë duke dhënë këto pamje të orientalizmit dhe okcidentalizmit pasi kërkon t’i japë një përmasë historike rrëfimit të tij etiko-politik të ndarjes Perëndim-Lindje tek shqiptarët. Ai shton se Maloki e përjashton krejtësisht historinë, pasi e kthen atë në një absurditet. Kulla në shkrimet që merr në konsideratë në artikujt e kësaj natyre do të vlerësojë lidhjen e ngushtë të Malokit me problemet shqiptare dhe për përkushtimin e tij ndaj tyre heq vija paralele me Nolin.

### **5. Kontekstualizimi i shkrimeve të Malokit në realitetin e sotëm**

Pohimi i Iser-it mbi papërcaktueshmërinë e tekstit, i cili mbështetet në tipare të modifikueshme më krijon mundësinë të justifikoj faktin që tekstet e Malokit janë shtjelluar nisur nga perceptime nga më të ndryshmet. Në këtë mënyrë lexuesi e ka plotësuar tekstin duke i zgjidhur këto papërcaktueshmëri përgjatë procesit të leximit, e njëkohësisht duke tërhequr tekstin në hapësirën e vet të përvojës e ka prodhuar atë.

Ky proces bëhet i dukshëm sidomos në shkrimet me karakter social të Malokit për shkak të problematikës së gjerë që trajtojnë duke u gjendur aktuale edhe sot në ditët tona. Studiues dhe publicistë të ndryshëm janë tunduar të rikontekstualizojnë idetë e tij në aspekte të ndryshme të realitetit.

Fatos Baxhaku duke u nisur nga një paragraf i shkruar nga Maloki të cilin e gjen më se aktual i

referohet mungesës së kulturës dhe etikës së komunikimit, si dhe mungesës së peshës së fjalës në ditët e sotme. Për Baxhakun është me vlerë guximi i Malokit, cilësi kjo, e cila nuk mungon në ditët e sotme në politikë, por dobësia qëndron në të mbështeturit e guximit në argumentet logjike, duke e karakterizuar politikën e sotme si fjalë boshe e me shumë mungesë personaliteti (Baxhaku 2003: 34).

Zef Ahmeti (Ahmeti 2005: 7) e inkadron mendimin e Malokit të lidhur me lidhshkrimin shqiptar në realitetin e sotëm kosovar, kur Kosova është në kërkim të modelit të suksesshëm të lidhshkrimit për të ruajtur statusin e fituar dhe njëkohësisht të krijojë një model me kulturë europiane. Mehmet Elezi (Elezi 2005: 7) idetë e Malokit të shprehura qartë në “*Oriental apo Okcidental?*” i rivendos në aktualitetin politik shqiptar të kohës duke akuzuar për cilësi të orientalistit përfaqësuesit e pozitës, e cila humbi zgjedhjet politike (më 2005). Po në këtë kuadër vjen këndvështrimi i Enis Sulstarovës (Sulstarova 2003: 3–4), i cili mbështetur në konceptet mbi oksidentalizmin dhe orientalizmin tek Maloki do të gjejë prezentë në realitetin e sotëm si paralelizma orientaliste ku, përdorimi i “*Perëndimit*” ka pësuar një inflacion dhe ku për çdo shfaqje negative të realitetit shqiptar përdoret epiteti lindor.

### **6. Vlerësimi i kritikës së Malokit**

Bazuar në konceptin e Ingardenit, se: *vepra letrare ekziston vetëm si një shtresë pikëpamjesh të skematizuara të cilat lexuesi duhet t’i konkretizojë* Hamdi Oruçi (Oruçi 1973: 149-166) fill pas vdekjes së Malokit do të shprehej mes notave të dhimbjes se kritika e tij ka qenë e rrumbullakët: shpesh në dukje e egër, por në të vërtetë kritika e tij nxjerr në pah personin ose veprën duke vënë në dukje ngjarjet kryesore, ose vargjet më të bukura ‘tue përmendë e krahasue veprat e këqija e vargjet e vorfna /.../. Ai qe pioner i kësaj gjinije letrare në botën shqiptare të vorfën’. Rëndësinë e shkrimeve të Malokit, Rugova (Rugova 2005: 132) e njeh të lidhur ngushtë me rolin e rëndësishëm që luajti në zgjimin e vetëdijes dhe përgjegjësisë së madhe ndaj fjalës kritike. Duke bërë të mundur fillësat në kritikën e kritikës në

letërsinë shqipe Sabri Hamiti (Hamiti 2009: 434) e vlerëson Malokin si kritik, shkrimet e të cilit karakterizohen nga kultura letrare, temperamenti kritik dhe toni polemik. Bazën e kërkimit të Malokit kudo e krijon një tezë e paravënë mbi nevojën e ruajtjes së kulturës vendase, madje edhe në letërsisë e modernitetit. Për Ndriçim Kullën Maloki përfaqësonte intelektualin e formuar, me horizont të gjerë kulturor, i cili në veprimtarinë e tij nisët nga kërkesa shkencore dhe nga synimi për të hedhur dritë sa më të plotë e objektive në problemet që trajtoi nga fusha e shkencave shoqërore dhe e studimeve letrare. Koço Bihiku do të evidentojë si specifikë të kritikës së Malokit trajtimin e argumentuar dhe, në rrafsh të gjerë të teksteve, shfrytëzimin e të dhënave statistikore, gjykimet e tij të pavarura dhe shprehjen e prerë e kategorike të mendimeve si dhe tonin polemik. Behar Gjoka e sheh vlerën e kritikës së Malokit në burimet artthënëse të materies autoriale, që gjendet në njohjen e thellë të kulturës shqipe, veçanërisht në përthithjen e vlerave të kulturës gjermanike. Shqyrtesat e kritikës letrare të Malokit - pohon ai, sendërojnë portretin e kritikut me kërkesa maksimale për shenjimin e kombëtares, socials dhe letraritetit. Ai do të theksojë se: *Ngjyresa e fjalëve nuk pengon ndërkomunikimin me cilindo lexues, madje i jep tonalitet shprehimor këndellës, ngjashëm me artthënie e Mjedës, Migjenit e dhjetëra autorëve të shquar të letrave shqipe* (Gjoka 2003: 18).

## 7. Përfundim

Nga sa u tha më lart duket qartë, nisur edhe nga tekstet e pakta që shqyrtuam nuk mund të konstatojmë me bindje se vepra e Malokit nuk ka patur një receptim të gjerë nga bashkohësit, duke mos vënë në raport të konsoliduar dykahësh marrëdhënien mes autorit dhe lexuesit. Ndryshe do të ndodhë me raportin e lexuesit në distancë kohore (i referohem receptimit të kohëve aktuale moderne), i cili shfaqet në përmasë tjetër me bashkëpunues.

Kështu pyetja: A ishte në koherencë kritika e Malokit me stadin e sistemit kritik të kohës? mund të marrë një përgjigje jo të plotë nisur

vetëm nga fakti që Maloki e ndërtonte kritikën e tij, duke u bazuar në parime, të cilat ishin në koherencë me "*kontekstin e kohës*". Kjo më shtyn të pohoj se lidhur me stadin e sistemit të kritikës Maloki i shton themeleve të vetëdijes për kritikën, të hedhura nga Konica, bazat e një kritike me vetëdije, në kërkim të një letërsie me frymë nacionale dhe të frymës nacionale në letërsi.

Duke iu referuar tipit të dytë dhe të tretë të receptimit të veprës së Malokit në ditët e sotme, duhet thënë se Maloki shfaqet si projektues i një mendimi kritik të së ardhmes të mbështetur në baza shkencore, teorike e metodike, siç do të tentojnë më vonë, Kuteli, Pipa etj. Shfrytëzimi i *distancës estetike të horizonti të pritjes* do të bëjë të mundur që shkrimet e tij bazuar në idenë nacionale, problematikën e gjerë shqiptare do të gjejnë terren për t'u marrë në konsideratë edhe sot. Maloki tenton të sjellë ndryshimin e përvojës kritike të kohës duke pretenduar të kultivojë një kritikë objektive, të prirur nga dialogimi me tekstin dhe ballafaqimi me metodat e teorisë psikanalitike e tematologjike, duke thyer në një farë mënyre "horizontin e pritjes letrare të zakonshme", duke shtuar projektimin e kritikës drejt së ardhmes në një drejtim të ri

## Bibliografia

- AHMETI, Isak (1999), Një figurë moderne shqiptare, Rilindja, 10 Mars, Tiranë.  
 AHMETI, Zef (2005), Lideri shqiptar sipas Krist Malokit, "55", nr. 229, Tiranë.  
 BAXHAKU, Fatos (2003), Të bekuar nga zoti të mallkuar nga djalli: Panorama, nr. 895, 10-11 gusht, Tiranë.  
 BIHIKU, Koço (2000), Krist Maloki- sociolog dhe kritik i mirënjohur i viteve '30: Të drejtat e njeriut, Nr. 1, Tiranë.  
 ELEZI, Mehmet (2005), Ikësit e PS nën vështrimin e Krist Malokit: 55, nr 229, Tiranë.  
 GJOKA Behar (2003), Krist Maloki shqiptari professor i Gracit: Shekulli, 2 qershor, Tiranë.  
 ORUÇI Hamdi (1973), Prof Krist Maloki vdiq: Shejzat, XVII, nr.5-8, Romë.  
 HAMITI Sabri (2010), Poetika, Botimet 55, Tiranë.

JAUSS Hans Robert (2001), *Perche la storia della letteratura?* Gudia Editori, Napoli.

KULLA Ndrçim (2002), *Neoshqiptarizma, Plejad*, Tiranë.

KULLA Ndrçim (2001), Krist Maloki mendimtar i cilësisë: RD, nr. 2775, 28 shkurt, Tiranë.

KUTELI Mitrush (1941), *Shënime letrare, botim i autorit*, Tiranë.

KUTELI Mitrush (1944), *Poetë dhe detraktorë: Revista letrare*, 15 prill, Tiranë.

L. (1934) *Gjurmime në shpirtin e shqiptarit (mbas studimeve të Dr Krist Malokit)*: Leka, n. 3, 1 mars, Tiranë.

LUSHAJ, Besiana (2007), *Kur poeti krijonte për kombin (intervistë me Arjan Lekën)*: ABC, nr. 196, 7 Prill, Tiranë.

MALOKI Krist (1934), *Prej kah vjen kanuni i Lek Dukagjinit*: Besa, 6 Nëntor, Tiranë.

MALOKI Krist (1935), *Kundrime rreth shtetit korporativ*: Leka, nr. 3, Tiranë.

MALOKI Krist (1935), *Si duhet zëvendësue sistemi i së dhjetës*: Besa, nr. 11-17, Tiranë.

MALOKI Krist (2003), *Oriental apo Okcidental*, Plejad, Tiranë.

MALOKI Krist (2005), *Refleksione- kritikë letrare, anaiza dhe mendime (përgatiti: Albert Ramaj)*, Faik Konica, Prishtinë.

MUHAMETAJ Enver (2008), *Mendimi letrar shqiptar, 1939-1944*, Bota shqiptare, Tiranë.

RUGOVA Ibrahim (2005), *Kahe dhe premise të kritikës letrare shqiptare 1504-1984*, Rilindja, Prishtinë.

SULSTAROVA Enis (2003), *Orientalizmi i Krist Malokit*: Fjala, 10-11 Gusht, Prishtinë.